



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001900/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Durrës.

Drejtuar: Drejtues i Parë Lorenc SHEHU
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

DURRËS

Kryekomisar Geron SEITLLARI
Shef i Komisariatit të Policisë Durrës

DURRËS

Për dijeni: Drejtues Madhor Ardi VELIU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Durrës.

Inspektimi u krye në datën 11.06.2020, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e Procedurës Standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e Procedurës Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshme.

¹ Neni 81 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të policisë Durrës, kryekomisar Geron Seitllari dhe shefin e rendit z. Melsi Koçi, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, drejtuesit e Komisarariatit informuan grupin e inspektimit, për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisarariat, trajtimin sipas të drejtave ligjore që gëzojnë personat e privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë që kryenin shërbimin në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të këtij komisarati, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë inspektimit që u zhvillua në këto ambiente.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për lyerjen e dizifektimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për vendosjen në ambientin e shoqërimit të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për zëvendësimin në dhomat e sigurisë të dyshekëve të dëmtuar, larjen e batanijeve, si dhe pajisjen me jastek të shtretërve.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin më vete të dhomës për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë dhomë.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e dhomës së mjekut në ambientin e sigurisë, me frigorifer për mbajtjen e një pjese të medikamenteve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike.

Gjatë inspektimit, u kontrolluan gjithashtu edhe zbatimi i masave të marra nga drejtuesit dhe punonjësit e policisë të këtij komisarati, për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19 dhe protokollin shëndetësor që duhet të ndiqet për kthimin në normalitet. Gjatë

kontrollit u evidentua se, ishin marrë masa për krijimin e dokumentacionit me urdhërat dhe udhëzimet e miratuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit dhe DVP Durrës, për gjithë periudhën e emergjencës deri në përfundim të fazave të pandemisë. Strukturat përgjegjëse në drejtorinë e policisë, kishin kryer sipas një grafiku për periudhën Maj – Qershor 2020, dizifektimin e ambienteve të punës dhe të ambienteve të shoqërimit e të sigurisë në Komisariatin e Policisë Durrës dhe komisaritet e policisë në varësi të saj, si dhe kishin planifikuar dhe shpërndarë në bazë të nevojave për stafin dhe punonjësit e policisë maska mbrojtëse, doreza dhe dizifektantë për pastrimin e duarve. Dizifektime shtesë të ambienteve ishin kryer dhe nga strukturat e pushtetit vendor në territorin që mbulon kjo drejtori.

Por, krahas masave të marra, nga inspektimi u evidentua se nuk ishin afishuar në vende të dukshme posterat informues për zbatimin e protokollit anti COVID-19, ato për ruajtjen e distancës fizike dhe sociale në kontaktet me njëri tjetrin dhe me qytetarët, si dhe vendosja e dizifektantëve për pastrimin e duarve në ambiente të aksesueshme si në hyrje dhe mjediset e brendshme të komisarimit.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se në Komisarimat e Policisë Durrës, krahas masave të marra në përmirësimin e situatës përsa i takon respektimit të të drejtave që gëzojnë personat e privuar nga liria në mjediset e policisë, kishte dhe disa problematika në lidhje me plotësimin e kushteve materiale në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në plotësimin e standardeve ndërkombëtare për garantimin e të drejtave ligjore të këtyre personave.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarimat e Policisë Durrës, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.

Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 4 (katër) dhoma shoqërimi të ndara më vete 2 (dy) dhoma për mbajtjen dhe trajtimin e personave të rritur, 1 (një) dhomë për femra dhe 1 (një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 5x3 m², me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve me kapacitet deri 15 persona, me kushte normale për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që iu njeh ligji këtyre personave.

Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për mirëmbajtje dhe për dizifektim në mënyrë periodike. Dyert e dhomave ishin të siguruara, ato mbylleshin me bravë të rregullt dhe me çelës.

Dritaret në dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me skarë hekuri dhe lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, ndërkohë dhomat kishin ndriçim edhe nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pajisura me karrige/stola druri me skelete metalike të fiksuara në dysHEME për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualeti i përbashkët për meshkuj dhe femra, pajisur me lavaman dhe çezëm me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Ndërkohë, sipas

procedurave standarde, ambienti i shoqërimit duhet të ketë dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra.

Në mjedisin dhe korridorin e shoqërimit, ishin të instaluar kamera për monitorimin e veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar përgjatë 24 orëve.

Gjatë inspektimit u evidentua se në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, por ato nuk ishin të afishuar në dhomat e shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar, por sipas informacionit të shefit të rendit dhe punonjësit të shërbimit në zyrën e informacionit, personave të shoqëruar ju jepej një kopje e kartës me të drejtat e tyre në momentin që ata hynin në dhomat e shoqërimit.

Në ambientin e shoqërimit ndodhej dhoma për marrjen e shenjave të gishtave të këtyre personave, me qëllim identifikimin në kohë dhe të saktë të personit, por nuk kishte një dhomë më vete për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të specialistëve të policisë të këtij komisariati, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera për të vëzhguar veprimet që kryhen nga punonjësit e policisë gjatë seancës për intervistimin e tyre.

Mungesa e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe e sistemit të monitorimit me kamera, mund të përbëjnë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, grupi i inspektimit nuk konstatoi në ambientin e shoqërimit, sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Durrës, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Në këtë ambient ndodheshin 8 (tetë) dhoma sigurie, nga të cilat 6 (gjashtë) për meshkuj madhorë, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti zyrtar i dhomave të sigurisë ishte për trajtimin dhe sigurimin e 8 (tetë) personave të arrestuar/ndaluar. Ndërkohë, në kohën e inspektimit grupi i monitorimit konstatoi se, në dhoma ishin akomoduar 14 persona me statusin e të arrestuarit apo të ndaluarit, duke krijuar një situatë mbipopullimi me 6 persona tej kapacitetit zyrtar të dhomave të sigurisë, të cilët flinin me dyshekë të shtruar në dysheme.

Mbipopullimi kishte sjellë si pasojë që 2-3 persona të akomodoheshin në një dhomë sigurie me sipërfaqe 10 m², në shkelje të qartë të standardit të përcaktuar në aktet ligjore

dhe dokumentet ndërkombëtare, ku përcaktohet se një personi të arrestuar apo ndaluar duhet ti sigurohet një sipërfaqe jo më pak se 6 m² për çdo person. Kjo situatë, bëhet akoma më problematike pasi në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës, akomodohen dhe personat e ndaluar/arrestuar nga komisarariatet e policisë të Krujës dhe të Shijakut, në varësi të DVP Durrës. Mbipopullimi në dhomat e sigurisë, bëhet një problem më shqetësues në kushtet e pandemisë për parandalimin e sëmundjes COVID-19, ku kërkohen masa strikte për ruajtjen e shëndetit të personave që akomodohen në këto mjedise, si dhe për ruajtjen e distancës fizike dhe sociale mes tyre.

Ky shqetësim është konstatuar në DVP Durrës edhe gjatë vizitës inspektuese të CPT (European Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) në Shqipëri në vitin 2018, raport i të cilit është botuar në vitin 2019². Në rekomandimin 8 të këtij raporti theksohet se, dhomat e sigurisë në komisarariatet e policisë duhet të sigurojnë një sipërfaqe prej 6-8 m² vetëm për një person. Ndërkohë, që në përgjigjen e Qeverisë Shqiptare për këtë rekomandim, theksohet se, nuk ka persona të arrestuar/ndaluar, që mbahen në dhoma më pak se 5m² dhe në dimensione 5-8m², më shumë se një person.

Ekspertët e MKPT- së të Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vizitave tematike të kryera në dhomat e sigurisë të Komisariateve të Policisë kanë konstatuar në jo pak raste mbipopullime, ashtu si edhe mungesë të fondeve për kryerjen e investimeve, me qëllim përmirësimin e kushteve teknike dhe materiale të këtyre ambienteve, për një trajtim sa më dinjitoz të personave të ndaluar apo arrestuar. Kjo situatë, është evidentuar gjithashtu edhe në raportet vjetore të inspektiveve me rekomandimet përkatëse të MKPT- së, por vërejmë se, ndryshimet janë të pakta dhe të pamjaftueshme, krahasuar me problematikën që ekziston në dhomat e shoqërimit e të sigurisë, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë.

Nga intervistat me personat e ndaluar/arrestuar, rezultoi se koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë të personave me masë sigurie “arrest me burg”, sipas urdhërit të lëshuar nga organi i prokurorisë, ishte deri në 96 orë brenda afati ligjor maksimal për vleftësimin e masës të sigurisë nga ana e gjykatës.

Por, grupi i inspektimit konstatoi se, në dhomat e sigurisë ndodheshin dy persona të ndaluar nga organi i policisë, të cilët ishin të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe qëndronin në këto ambiente tej afateve ligjore, në pritje të përgjigjes të kërkesës të DVP Durrës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kërkesat nga ana e organit të policisë ishin kryer menjëherë brenda ditës, ndërkohë pretendohet se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kishte vonesa për transferimin menjëhershëm të këtyre personave në IEVP, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale. Këto raste, përbënin një shqetësim për Drejtorinë/komisariatit të Policisë së Durrësit, pasi ndonëse sporadike ato krijonin premisë për mbipopullime në dhomat e sigurisë.

Gjithashtu, kjo praktikë është gjetur shkelje gjatë vizitës inspektuese të CPT-së në Shqipëri, ku në raportin e të sipërpërmendur rekomandohet se, “*Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në arrest policor të*

² Raporti CPT për Shqipërinë botuar më 17 shtator 2019.

*personave me masë sigurie "arrest në burg" dhe të dënuarit me burgim me një vendim të formës së prerë"*³.

Në përgjigje të rekomandimit të CPT-së, institucionet shtetërore përgjegjëse Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 "Për transferimin në IEVP të të ndaluarve me masën e sigurisë "paraburgim" dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, ku përcaktohen procedurat dhe afatet për transferimin e këtyre personave jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit⁴.

Por, nga kontakti me drejtuesit e policisë të kësaj drejtorie, ky shqetësim vazhdonte të ishte prezent dhe marrëveshja e bashkëpunimit megjithëse e lidhur prej 1 viti, rezulton se nuk kishte gjetur zbatim në praktikë.

Gjatë inspektimit, u evidentua se në dhomat e sigurisë mundësohej ajrimi, ndriçimi natyral dhe artificial i mjaftueshëm. Në çdo dhomë ishin instaluar zile për komunikimin e personave të ndaluar apo arrestuar me personelin e shërbimit në rast nevojë. Gjithashtu, në zyrën e përgjegjësit të dhomave në ambientet e sigurisë kishte aparat telefonik, për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me tualete, si dhe me orenditë e nevojshme për jetesë për personat që akomodohen aty si krevat, dyshekë dhe batanije, të cilët ishin në gjendje të mirë materiale. Ato ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por kishin nevojë për mirëmbajtje, me qëllim për të siguruar kushte dinjitoze për personat që qëndrojnë në këtë ambient.

Në paradhoma, ishin instaluar çezma me ujë të rrjedhshëm për larje e pastrim vetjak të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërsa për larjen e trupit, kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë) i cili ndodhej në korridorin e dhomave të sigurisë. Gjithashtu, në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për periudhën e dimrit.

Larja e batanijeve dhe ndërrimi i materialeve të vjetëruara apo dëmtuara që shërbenin për fjetje në dhomat e sigurisë, kryhej periodikisht sipas një grafiku të miratuar nga struktura përgjegjëse në drejtorinë e policisë Durrës.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por mungonte frigoriferi për ruajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike. Në një raft, mbaheshin kartelat mjekësore me dinamikën e vizitave mjekësore për çdo person të ndaluar/arrestuar.

Në këtë ambient ndodhej një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët, e cila shërbente dhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave që merren në pyetje, por nuk kishte kamera për mbajtjen në vëzhgim të

³ Raporti CPT botuar më 17 shtator 2019. <https://rm.coe.int/168097986b>

⁴ Rekomandimi 1, faqe 8, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT. <https://rm.coe.int/16809cb571>

veprimeve që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore me të ndaluarit/arrestuarit dhe anasjelltas për të parandaluar çdo veprim të mundshëm të këtyre personave.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e sigurisë

Në kohën e inspektimit, në ambientet e sigurisë ndodheshin 14 persona të ndaluar/arrestuar, në pritje të vlerësimit të masave të sigurisë nga gjykata.

Nga intervistat që zhvilloi grupi i inspektimit me personat e ndaluar/arrestuar, u konstatua se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte nga punonjësit e shërbimit të dhomave të sigurisë, si dhe gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Ata nuk trajtoheshin në mënyrë denigruese apo jo humane, si dhe ndaj tyre nuk ushtrohej dhune fizike e psikologjike. Të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë. Ushqimi dhe gatimi i tij sigurohej dhe shërbehej me catering, nga subjektet private.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjenës vetjake dhe të ambientit në dhomë si sapun, detergjente, letra higjenike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Personave të ndaluar/arrestuar iu ishin siguruar dhe dizifektantë për pastrimin e shpeshtë të duarve, për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, si dhe maska mbrojtëse. Por, mbipopullimi në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës, ngelet një problem shqetësues në kushtet e pandemisë, kur protokollit shëndetësor parashikon se është e domosdoshme ruajtja e distancimit social dhe fizik të personave.

Ndaj është e nevojshme, që drejtuesit e policisë të këtij institucioni, të marrin masa organizative për reduktimin në maksimum të rasteve të mbipopullimit në dhomat e shoqërimit dhe sidomos në dhomat e sigurisë.

Regjistri i personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar

Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarariatit të Policisë Durrës, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqytja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁵.

⁵ *Kreu VII, Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

Në këtë Komisarjat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Kjo u vërtetua nga grupi i inspektimit dhe për rastet kur personat ishin ndaluar apo arrestuar nga punonjësit e policisë të komisarjateve në Krujë dhe Shijak, të cilët dërgoheshin në dhomat e sigurisë të komisarjatisë të policisë Durrës. Në proces verbalet e ndalimit/arrestimit të personave ishte shënuar ora e shoqërimit të tyre që në momentin e ndalimit/arrestimit nga punonjësit e policisë të komisarjatisë Krujë dhe Shijak.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarjat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën e inspektimit nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga këta persona.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarjatin e Policisë Durrës specialistët e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në mjediset e policisë, në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin e veprimeve procedurale të kryera nga ana e punonjësve të policisë.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit në vijimësi i ka rekomanduar organeve të Policisë së Shtetit marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse përmendëm edhe më lart, ky rekomandim nuk është zbatuar ende në këtë Komisarjat.

Po ashtu, edhe dhoma për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore që ndodhej në dhomat e sigurisë, nuk ishte me kushte të përshtatshme pune (shërbente dhe për takime me avokatët), si dhe nuk kishte të instaluar sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁶, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Nga monitorimi që u bë në zyrat e punonjësve të policisë që ndodheshin në kohën e inspektimit në këtë Komisarjat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit ishin të mitur, kryerja e veprimeve procedurale bëhej nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dhe në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i Prokurorisë Durrës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, e cila ishte e afishuar në ambiente të dukshme dhe të aksesueshme. Ndërsa psikologu ishte në organikë të DVP Durrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në ambientin e sigurisë të këtij Komisarjati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë, por ato nuk ishin të vendosur në ambientet brenda dhomave ku qëndrojnë këta persona, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme nga këta ana e tyre.

U konstatua se në këtë Komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimitin e çështjes përkatëse.

Ndërkohë, grupi i inspektimit në intervistat me disa nga personat e ndaluar apo të arrestuar, konstatoi se, disa persona nuk ishin të pajisur me proces-verbalin për arsyet e ndalimit apo arrestimi dhe letrën e të drejtave që gëzojnë këta persona, gjë e cila bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 34/b dhe 246/1 të Kodit të Procedurës Penale. Rastet e identifikuar nga grupit të inspektimit, duhet të bëhen objekt analize dhe të nxirren përgjegjësitë për oficerët e policisë gjyqësore që nuk kanë pajisur personat e ndaluar/arrestuar me dokumentacionin e sipërpërmendur.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit të personave në dhomat e sigurisë të Komisarjatisë të Policisë Durrës, si dhe zbatimin e detyrimeve që parashikohen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPSH dhe DPB me nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “Për transferimin në I EVP të të

ndaluarve me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë”.

2. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen dhe moslejimin hyrjen në dhomat e sigurisë të personave të ndaluar apo të arrestuar, që nuk janë të pajisur me proces-verbalin për arsyet apo vendimin e ndalimit/arrestimit dhe letrën e të drejtave që gëzojnë këta persona, të firmosur nga ana tyre.
3. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin më vete të dhomës të intervistimit të personave të shoqëruar dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit audio-viziv në këto dhoma.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen në dhomat e shoqërimit të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në organet e policisë, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme dhe të njihen me këto të drejta, nga këta persona.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në lidhje me rekomandimet e CPT-së në raportin e botuar në 17 Shtator 2019 për Shqipërinë, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, për plotësimin në kohë e me përgjegjësi të regjistrit të kërkesë/ankesave të shtetasve, me qëllim bërjen efektive të sistemit të ankesave.
7. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e dhomës ku kryhen vizitat mjekësore me frigorifer për mbajtjen e një pjese të medikamenteve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërgjegjësimin e stafit të punonjësve të policisë të këtij komisariati, për zbatimin e masave të parashikuara në protokollin shëndetësor në mbajtjen e maskave mbrojtëse, përdorimin e disinfektantëve dhe ruajtjen e distancimit fizik dhe social, për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA